Nissinen: Ngërçi i zgjatur e pengon progresin në disa fusha

Faqe 3

PDK-ja e dërgon në Kushtetuese vendimin e ZRRE-së

Faqe 4

Izraeli e fillon ofensivën në qytetin e Gazës

Faqe 6

Drita bën hap të madh drejt Ligës së Konferencës

Faqe 15

KOHA DITORE

e premte • 22 gusht 2025

Numri 10101

www.koha.net

KQZ-JA REFUZON TA CERTIFIKOJË PARTINË MË TË MADHE TË SERBËVE, SHKAKU I KANDIDATËVE ME FUNKSIONE NË STRUKTURA PARALELE

Lista Serbe nuk certifikohet për zgjedhjet e 12 tetorit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk e ka certifikuar Listën Serbe për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Me dy vota për, dy kundër dhe shtatë abstenime, certifikimi u refuzua, pasi paraprakisht anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje në KQZ publikuan dokumente që tregojnë se kandidatë të Listës Serbe për kryetarë komunash apo asamblistë, mbajnë pozita në organet paralele të Serbisë në Kosovë

Fitim Gashi
Rinesë Qorri

PRISHTINË, 21 GUSHT – Lista Serbe nuk është certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Për certifikim të kësaj partie votuan vetëm dy anëtarë, dy të Vetëvendosjes votuan kundër, ndërkaq shtatë anëtarët që u përkasin subjekteve të tjera politike, abstenuan.

Në mbledhjen e KQZ-së që është organizuar të enjten, pro votuan kryetari Kreshnik Radoniqi dhe përfaqësuesja e Listës Serbe. Dy anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje votuan kundër, ndërsa abstenuan anëtarët e partive të tjera.

Anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje në KQZ, Sami Kurteshi e Alban Krasniqi, e kundërshtuan certifikimin e kësaj partie, pasi publikuan dokumente që tregonin se kandidatë të Listës Serbe për kryetarë komunash apo asamblistë, mbajnë pozita në organet paralele të Serbisë në Kosovë.

"Kemi një parti politike, që ka trashëgimi terroriste dhe një të tashme terroriste. Përveç kësaj, ka elementë të tjerë, persona që kanë marrë pjesë edhe në sulme terroriste, edhe në sulme të ndryshme. Tash i kemi edhe veprimet e institucioneve për ndjekje penale. Në mesin e tyre ka edhe persona që në të vërtetë, në mënyrë subversive punojnë kundër Republikës së Kosovës. Ata mbajnë pozicione në organet e ashtuquajtura paralele të Serbisë. Dhe njëkohësisht mbajnë pozicione, cilado qofshin ato, në organet e Republikës së Kosovës", ka thënë Kurteshi fillimisht, teksa e ka marrë shembull kandidatin e Listës Serbe për kryetar të Novobërdës, Sasha Millosheviq, që është edhe kryetar i komunës paralele të Gjilanit, i emëruar nga autoritetet e Serbisë.

Kurteshi ka thënë se Millosheviqi është "kamxhiku i Radoiçiqit për Anamoravë". Ai ka thënë se këta persona e kanë cak minimin e Republikës dhe shkatërrimin e sovranitetit të Kosovës.

Pas Kurteshit, ka reaguar anëtari i Partisë Demokratike, Arianit Elshani. Ai ka thënë se informatat e tilla duhet t'i ofrohen KQZ-së në mënyrë institucionale përmes organeve të sigurisë.

Elshani ka bërë të ditur se PDK-ja ka vendosur të abstenojë në votim deri sa të ketë veprime konkrete nga institucionet e sigurisë.

"Sa herë vjen koha e zgjedhjeve, kjo përsëritet. Këto informata kisha pasë dëshirë që t'i pranoj në mënyrë institucionale e jo që t'i shohim tash. Por, sidoqoftë, si përfaqësues të PDK-së, abstenojmë nga votimi për certifikimin e Listës Serbe duke i marrë parasysh këta kandidatë, por edhe të gjitha ato diskutimet. S'jemi për certifikim, por abstenojmë nga votimi derisa nuk ka veprime konkrete nga institucionet e tjera të sigurisë, që na e tregojnë rrugën që duhet të ndiqet për këtë subjekt politik", ka thënë ai.

vijon në faqen e dytë

DREJTUESIT E OVL SË UÇK-SË BËJNË THIRRJE PËR PJESËMARRJE MASIVE NË PROTESTËN E 14 SHTATORIT PARA SPECIALES

Më 14 shtator protestohet në Hagë

Sanie Jusufi

PRISHTINË, 21 GUSHT – Në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), më 14 shtator në Hagë pritet të mbahet një protestë, e organizuar nga mërgata dhe me mbështetje nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së.

Kjo protestë është thirrur pas asaj të 7 gushtit që u mbajt në Prishtinë, në të cilën qytetarë të shumtë shprehën revoltë ndaj gjykatës me seli në Hagë, për të cilën thanë se ka devijuar nga misioni. Kryetari i OVL së UÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se protesta do të organizohet për t'i shprehur pakënaqësitë ndaj Dhomave të Specializuara.

"Arsyeja pse mbahet kjo protestë më 14 shtator, më datën 15 shtator do të jetë dështimtari i parë që do të jetë i mbrojtjes tonë, është nga Amerika dhe ne do të dalim në mbështetje të tyre dhe do të dalim t'i drejtojmë të gjitha pakënaqësitë tona, që ajo gjykatë është duke punuar dhe vepruar. Gjithçka mund të ketë aty, mund të thirret edhe në emër të drejtësisë, por drejtësi nuk ka në atë gjykatë dhe ne si organizata të dala nga lufta kemi shprehur në moment të caktuar që t'i dalim në mbështetje bashkëluftëtarëve tanë, nga Amerika dhe Evropa, që t'i bashkëngjitemi kësaj proteste", ka thënë Gucati.

E, Fatmir Koca, njëri nga organizatorët e protestës nga mërgata, ka thënë se qëllimi i saj është që t'i tregohet botës që lufta e Kosovës ka qenë e drejtë.

"Luftën e kemi fituar me gjakun e dëshmorëve dhe bashkëpunimin e aleatëve tanë. Kemi interesim të madh nga mërgimtarët gjithandej diasporës, nga Amerika, nga Australia e Largët edhe Evropa, që më 14 shtator të jemi të gjithë të bashkuar dhe është koha e fundit që të jemi bashkë dhe t'i tregojmë botës që lufta jonë ka qenë e drejtë dhe kjo gjykatë që po mbahet ndaj krerëve të luftës është e padrejtë", ka thënë Koca.

Ndërsa Xhavit Jashari, kryetar i Shoqatës së Familjes së Dëshmorëve, ka thënë se përmes kësaj proteste do të tregohet se në Hagë në emër të drejtësisë po ndodh padrejtësi.

Nga 15 shtatori, mbrojta e ish-krerëve të UÇK-së do ta nisë paraqitjen e dëshmive të dëshmitarëve të mbrojtjes.

Ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, akuzohen për krime lufte e krime kundër njerëzimit. Ata janë duke u mbajtur në paraburgim nga viti 2020.

© KOHA Ditore

Sfida e huazimeve në shqip përballë kontakteve gjuhësore për identitet profesional

Kontaktet gjuhësore luajnë një rol qenësor për albanologjinë, sepse janë të shumta dhe intensive. Mendohet se 90 për qind e leksikut të trashëguar të shqipes është zëvendësuar me fjalë të huazuara, por kjo gjë nuk mund të vërtetohet me siguri, për shkak se nuk ka ndonjë përmbledhje gjithëpërfshirëse për fjalësin e ...

Faqe 10